

ANALIZA GJINORE E KURRIKULAVE NË ARSIMIN PPROFESIONAL NË SHQIPËRI

Ky punim është realizuar nga Qendra Europiane në kuadër të Laboratorit të Parë të të Drejtave të Njeriut në vend, në bashkëpunim me Komitetin Shqiptar të Helsinkit dhe studentë të Fakulteteve të Drejtësisë, në kuadër të nismës “Jo Korrupsionit, Po Demokracisë”, mbështetur financiarisht me fonde të Qeverisë Suedeze.

Tiranë 2024

PËRMBAJTJA	
SHKURTIME	3
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	4
I. HYRJE	5
II. METODOLOGJIA	7
III. KUADRI LIGJOR, INSTITUCIONAL DHE POLITIK	8
• 3.1 Legjislacioni ndërkombëtar	8
• 3.2 Legjislacioni i brendshëm.....	9
3.2.1. Arsimi Profesional	9
3.2.2. Barazia Gjinore.....	10
• 3.3 Kuadri institucional	10
• 3.4 Dokumentet strategjike.....	12
IV. ANALIZA E KURRIKULËS DHE FOKUS GRUPET	15
V. GJETJET KRYESORE	19
VI. REKOMANDIME	20
• SHTOJCA - ANALIZA GJINORE E TEKSTEVE SHKOLLORE TË ARSIMIT TË PËRGJITHSHËM NË ARSIMIN DHE FORMIMIN PROFESIONAL	22
BIBLIOGRAFIA	28

SHKURTIME

AFP	Arsimi dhe Formimi Profesional
AKAFPK	Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve
AKPA	Agjencia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi
BE	Bashkimi Evropian
CEDAW	Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave
EFA	Arsimi për të Gjithë
KEDNJ	Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
KKBGJ	Këshilli Kombëtar për Barazinë Gjinore
MASR	Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
OZHM	Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit
RSH	Republika e Shqipërisë
SDG	Zhvillimit të Qëndrueshëm
SKBGj	Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030
UN	United Nations (Kombet e Bashkuara)
UNICEF	Organizata e Kombeve të Bashkuara për Fëmijët

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky dokument politikash ka për qëllim **evidentimin e problematikave dhe adoptimin e një qasjeje gjithëpërfshirëse në sektorin e arsimit profesional**. Përpos identifikimit të problematikave dhe advokimit për qasje ndaj rekomandimeve, përmes këtij dokumenti politikash synohet edhe forcimi i bashkëpunimit dhe koordinimit ndërinstitucional mes profesionistëve që punojnë me arsimin e përgjithshëm dhe atë profesional.

Gjithashtu, ky dokument ka për qëllim të shqyrtojë **nëse dhe në çfarë mase parimet e barazisë gjinore janë pasqyruar në kurrikulën shkollore të formimit të përgjithshëm në arsimin profesional**, të identifikojë çështjet kryesore që lidhen me arritjen e qëllimeve të barazisë gjinore në arsim dhe ti paraqesë këto rekomandime në nivel politikash për të përmirësuar ndjeshmërinë gjinore në kurrikulën shkollore dhe tekstet shkollore. Të dhënat janë përfutur nga një analizë e përfaqësimit gjinor në tekstet shkollore shqiptare.

Materiali paraqet një panoramë të përgjithshme të intrumenteve ligjore kombëtare dhe ndërkombëtare dhe duke vijuar me një sërë konvetash të ratifikuara nga vendi ynë si dhe ligje të miratuara në kuadër të barazisë gjinore në shoqëri, por edhe strategji apo politika të ndërmarra në këtë kuadër në arsimin profesional.

Më tej do të bëjmë një përshkrim të objektivave dhe metodologjisë së ndjekur, duke analizuar mënyrën se si tekstet përshkruajnë gratë dhe burrat (si dhe vajzat dhe djemtë), duke **identifikuar dhe analizuar në mënyrë specifike rastet e paragjykimeve gjinore dhe përfaqësimin stereotipik** të grave dhe burrave në kontekstin e familjes, punësimit dhe shoqërisë. Po ashtu, është bërë dhe një përshkrim dhe sjellja në vëmendje e parimeve të barazisë gjinore duke referuar raporte dhe marrëveshje të shumta ndërkombëtare, që theksojnë rëndësinë e arritjes së barazisë gjinore në arsimin profesional.

Personat e angazhuar në projekt kanë kryer një analizë gjinore të kurrikulës, e cila është bazuar në një shqyrtim të detajuar duke përdorur një mostër përfaqësuese prej 8 teksteve shkollore si dhe duke parë përbërjen gjinore të grupeve të autorëve të teksteve në 3 vitet e arsimit profesional (lista e detajuar e teksteve gjendet në Shtojcën 1).

Ndër të tjera, elementët kryesorë të këtij shqyrtimi ishin prania e parimeve të barazisë gjinore në tekste, prania e stereotipeve gjinore tradicionale, përfaqësimi i grave dhe burrave në këto tekste si dhe përbërja e grupit të autorëve/eve. Për më tepër, gjetjet dhe rekomandimet u konsultuan me 36 mësues nga 5 shkolla profesionale në rang vendi, përmes zhvillimit të 2 diskutimeve konsultuese me pjesëmarrjen e 36 mësuesve të lëndëve të përgjithshme në arsimin profesional.

Dokumenti përmbillet me rekomandime dhe një analizë konkrete gjinore të teksteve shkollore të formimit të përgjithshëm në arsimin profesional.

I. HYRJE

Ky punim është zhvilluar duke marrë parasysh politikat dhe standardet, që reflektohen në dokumentet kombëtare dhe ndërkombëtare, ku ndër më të rëndësishmet përmendim Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, Deklaratën dhe Platformën për Veprim të Pekinit, Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW), Konventën e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftën kundër Dhunës ndaj Grave e Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit), ligji nr. 9970 dt. 24.07.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”, ligji nr.15, dt. 16.02.2017 “Për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë”, Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030, Strategjia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive 2023-2030. Në vijim do të paraqesim situatën aktuale të AFP në Shqipëri.

Shqipëria ka bërë hapa të konsiderueshëm në ngritjen e një sistemi institucional, hartimin e politikave të rëndësishme dhe në anëtarësimin në angazhime të ndryshme ndërkombëtare. Legjislacioni kombëtar për barazinë dhe antidiskriminimin i ka rrënjët në të drejtat dhe liritë themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, e miratuar në vitin 1998.

Në Kushtetutë garantohet e drejta për arsim të mesëm profesional për të gjithë fëmijët dhe të rinjtë pa dallim në përputhje me nenin 57 dhe 59 të saj. Kuadri ligjor gjithëpërfshirës përsa i përket arsimin profesional përcakton parimet udhëzuese dhe strukturën e sistemit të AFP-së, rolet dhe përgjegjësitë e aktorëve kryesorë, standardet e përgjithshme për ofrimin e AFP-së, vlerësimin dhe certifikimin. Këtu mund të përmendim: ligjin nr. 15, datë 16.2.2017 “*Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë*”; ligjin nr. 23, datë 10.5.2018 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 247, datë 4.3.2010 ‘*Për Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve*’”; Ligjin nr. 15, datë 13.3.2019 “*Për nxitjen e punësimit*”; si dhe Kodin e punës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar. Ndërsa në kuadrin ligjor referuar barazisë ligjore mund të përmendim ligjin nr. 9970, datë 24.07.2008 “*Për barazinë gjinore në shoqëri*” dhe ligjin nr. 221, datë 4.2.2010 “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*”, i ndryshuar.

Dokumentet strategjike të cilat kanë në përmbajtjen ose fokusin e tyre aspektin gjinor dhe arsimin profesional janë Strategjia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive 2023-2030, Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030, Strategjia Kombëtare për Zhvillimin dhe Integrimin 2021-2030 (SKZHI), si edhe Strategjia Kombëtare e Rinisë dhe Plani i Veprimtimit 2022-2029.

Sektori i Arsimin Profesional luan një rol qëndror në promovimin e barazisë gjinore si në drejtim të fuqizimit të grave, ashtu edhe në drejtim të çrrënjësjes së stereotipeve dhe paragjykimëve ekzistues midis të gjithë nxënësve. Për shkak të disa faktorëve, përfshirë qëndrimet stereotipike gjinore, vajzat janë të nënpërfaqësuar në edukimin profesional me vetëm 15.7% të nxënësve të regjistruar që janë vajza, gjatë vitit akademik 2022-2023.

Në bazë të këtyre të dhënave statistikore, si dhe duke vlerësuar rëndësinë e angazhimit të të gjithë aktorëve për një shoqëri gjithëpërfshirëse, Qendra Europiane shikon shumë të nevojshme shtyrjen përpara të edukimit gjinor në sistemin e arsimin profesional në Shqipëri, arsim i cili ende vazhdon

të konsiderohet si domein i djemve. Ekziston nevoja për integrimin e perspektivës gjinore në zhvillimin e kurrikulave dhe librave shkollorë, duke promovuar barazinë gjinore në sektorin e arsimit profesional.

Në vijim do të paraqesim një analizë të kuadrit politik, ligjor dhe institucional në lidhje me përfshirjen e edukimit gjinor në këtë sektor të arsimit parauniversitar. Analiza jonë është mbështetur dhe në gjetjet cilësore të gjeneruara nga diskutimet me mësues të 5 shkollave profesionale, si dhe analiza e disa teksteve shkollore vënë në dispozicion.

II. METODOLOGJIA

Së pari, do të bëhet një analizë e gjithë kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi lidhur me përfshirjen e edukimit gjinor në arsimin profesional, për të evidentuar parashikimet relevante dhe institucionet përgjegjëse. Kjo analizë do të vijojë me kuadrin strategjik, parë arritjet dhe hendeqet e strategjive të përfunduara, si dhe masat konkrete të politikave në fuqi. Gjithashtu, do të vijohet me ndjekjen e progresit për problematikat e referuara nga agjencitë ndërkombëtare në raportet e tyre për situatën e barazisë gjinore në Shqipëri.

Në vijim, Qendra zhvilloi intervista me 5 shkolla profesionale me mësues përgjegjës/ose drejtues për të diskutuar mbi edukimin gjinor në arsimin profesional [përse frekuentohet kryesisht nga djemtë, çfarë orësh ekstra-kurrikulare i dedikohen edukimit gjinor etj.], me qëllim kryesor identifikimin dhe dakordësimin e përbashkët të çështjeve dhe nevojave që do të prioritizohen në këtë sektor.

Me qëllim hartimin e një dokumenti politikash relevant, i cili do të reflektojë situatën aktuale në lidhje me përfshirjen e edukimit gjinor në arsimin profesional, Qendra përshtiu në këtë dokument një analizë të kurrikulës së lëndës së letërsisë parë në lentën gjinore për klasat e 10-11-12.

Ky dokument has kufizimin metodologjik sa i përket të dhënave sasiore, të cilat do të kishin gjeneruar edhe më shumë gjetje dhe përdorimi i alter-tekstit, i cili ka bërë të vështirë analizimin e teksteve nga të gjitha shtëpitë botuese. Kjo mangësi synon të plotësohet në hapat e radhës pas përfundimit të këtij projekti si fazë e parë, kjo dhe në kuadër të qendrueshmërisë së nismës.

III. KUADRI LIGJOR, INSTITUCIONAL DHE POLITIK

Ky seksion i referohet analizës ligjore kombëtare dhe ndërkombëtare të zbatueshme në sektorin e arsimit profesional në Republikën e Shqipërisë.

3.1 Legjislacioni ndërkombëtar

Standartet ndërkombëtare gjenden në akte të ndryshme ndërkombëtare, të cilat në momentin që ratifikohen me ligj, kanë efekt të drejtëpërdrejtë në Republikën e Shqipërisë, duke u bërë pjesë e *lex fori* (sistemit të brendshëm).

Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut – Që në aktin e parë ndërkombëtar të të drejtave të njeriut të miratuar në vitin 1948, është parashikuar në nenin 26 të saj se gjithkush ka të drejtën e shkollimit, e veçanërisht Arsimi teknik dhe profesional duhet të zgjerohet për t’u bërë i mundshëm për të gjithë. Kjo e drejtë, bazuar në nenin 2 dhe në nenin 7 të DUDNJ, duhet të gëzohet pa kurrfarë kufizimi përsa i përket gjinisë.

Konventa kundër Diskriminimit në arsim¹ - Kjo Konventë mbron gjithë qytetarët nga diskriminimi në arsim. Në të sanksionohet barazia për të gjitha nivelet arsimore dhe për të drejtat e grupeve minoritare.

Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore² – Në nenin 13, pika 2, shkronja b parashikohet se arsimi i mesëm, në format e tij të ndryshme, duke përfshirë arsimin e mesëm teknik dhe profesional, duhet të jetë i përgjithshëm dhe i hapur për të gjithë me të gjitha mjetet e përshtatshme sidomos me vendosjen progresive të ndjekjes së mësimin falas. Gjithashtu, bazuar në nenin 2, shtetet palë të këtij Pakti zotohen të garantojnë që të drejtat e shpallura në këtë Pakt, të ushtrohen pa kurrfarë diskriminimi të bazuar në racë, ngjyrë, seks, gjuhë, fe, opinion politik ose çdo opinion tjetër, origjinë kombëtare a shoqërore, pasuri, lindje ose çdo gjendje tjetër.

Konventa mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave³ –Në nenin 10 të saj është parashikuar detyrimi i shteteve palës si Shqipëria për të marrë të gjitha masat e përshtatshme për të eliminuar diskriminimin ndaj grave, me qëllim që t’i sigurohen atyre të drejta të barabarta me burrat në fushën e arsimit. Gjithashtu, parashikohen kushte të njëjta të bërjes së karrierës dhe të kualifikimit profesional, të frekuentimit të shkollave dhe të marrjes së diplomave në arsimin teknik profesional. Institucionet përkatëse duhet të kujdesen për eliminimin e çdo koncepti stereotip për rolin e burrave dhe të grave në arsimin profesional, veçanërisht duke rishikuar tekstet dhe programet mësimore dhe duke përshtatur metodat e mësimdhënies.

¹ Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë më 21.11.1963.

² Aderuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin nr. 7511/1991 “Për aderimin në Paktin Ndërkombëtar mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore”

³ Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin nr. 7767/1993 “Për aderimin në Konventën e OKB-së për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave”

Konventa për të Drejtat e Fëmijës⁴ – Në nenin 28 të saj parashikohet se Shtetet Palë njohin të drejtën e fëmijës për arsimim dhe, me qëllim që të arrihet kjo e drejtë, hap pas hapi dhe mbi bazën e mundësive të barabarta, në mënyrë të veçantë ata inkurajojnë zhvillimin e formave të ndryshme të arsimit të mesëm si të përgjithshëm, dhe profesional.

Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut – Protokollin nr. 1 i KEDNJ, në nenin 2 të tij, parashikon të drejtën për arsim, e cila parë së bashku me nenin 14 të KEDNJ për ndalimin e diskriminimit për shkak të seksit plotëson panoramën tonë për qëllim të këtij punimi.

Karta Sociale Europiane – Në nenin 10 të saj promovohet ushtrimi efektiv i të drejtës për trajnim teknik dhe profesional.

Karta për edukimin për qytetari demokratike dhe për të drejtat e njeriut⁵ – Ky dokument për të nxënë e efektshëm në fushën e edukimit kërkon përfshirjen të një numri të madh vendimmarrësish, si: politikbërës, specialistë arsimit, nxënës, prindër, institucione dhe, autoritete arsimore, punonjës civilë, organizata jo qeveritare, organizata rinore, media dhe publiku i gjerë.

Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit⁶ – Në kuadër të anëtarësimit të vendit në Bashkimin Evropian, nënshkrimi dhe hyrja në fuqi e saj e detyron Shqipërinë, respektivisht në kuadër të nenit 100 të saj, të rrisë nivelin e përgjithshëm të arsimit të qytetarëve dhe të garantojë të drejtën për arsim për të gjithë individët pa dallim race, gjinie, besimi ose feje. Gjithashtu, në paragrafin e fundit të këtij neni parashikohet se palët duhet të marrin parasysh njohjen e publikut me *acquis-in* e BE-së.

Deklarata e Pekinit dhe Platforma për Veprim – Ndër fushat kritike të interesit të saj janë pabarazitë, pamjaftueshmëritë dhe qasja e pabarabartë në arsimim dhe trajnim. Prandaj, Deklarata synon të sigurojë qasje të barabartë, si dhe trajtim të barabartë të grave dhe burrave në arsimim dhe trajnimin e tyre profesional.

3.2 Legjislacioni i brendshëm

3.2.1. Arsimi Profesional

Arsimi dhe Formimi Profesional rregullohet në një sërë aktesh ligjore në Republikën e Shqipërisë. Konkretisht, në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në aktin themeltar të shtetit shqiptar, garantohet e drejta për arsim të mesëm profesional për të gjithë fëmijët dhe të rinjtë pa dallim në përputhje me nenin 57 dhe 59 të saj. Vitet e fundit është punuar shumë për krijimin e një kuadri ligjor gjithëpërfshirës, i cili përcakton parimet udhëzuese dhe strukturën e sistemit të AFP-së, rolet dhe përgjegjësitë e aktorëve kryesorë, standardet e përgjithshme për ofrimin e AFP-së, vlerësimin dhe certifikimin. Këtu mund të përmendim: Ligjin nr. 15, datë 16.2.2017 “*Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë*”; Ligjin nr. 23, datë 10.5.2018 “*Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 247, datë 4.3.2010 ‘Për Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve’*”;

⁴ Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin nr. 7531/1991 “Për ratifikimin e Konvetës së OKB-së për të drejtat e fëmijës”

⁵ Miratuar në kuadër të Rekomandimit të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës CM/Rec (2010)7.

⁶ Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin nr. 9590, datë 27.7.2006.

Ligjin nr. 15, datë 13.3.2019 “Për nxitjen e punësimit”; si dhe Kodin e punës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar. Gjithashtu, Arsimi dhe Formimi Profesional rregullohet nga një sërë aktesh nënligjore, duke përmendur:

- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.198 datë 2.3.2015 “Për procedurat e krijimit, riorganizimit dhe mbylljes të institucioneve publike, ofruese të Arsimit dhe Formimit Profesional”;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 17/2020 “Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programeve të nxitjes së punësimit nëpërmjet punësimit, formimit në punë dhe praktikave profesionale”;
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 194, datë 31.3.2021 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 17, datë 15.1.2020, ‘Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programeve të nxitjes së punësimit nëpërmjet punësimit, formimit në punë dhe praktikave profesionale’”, të ndryshuar;
- Udhezimi nr. 6, datë 24.2.2015 “Për kriteret e përgjithshme dhe procedurat për marrjen në punë të personelit të mësimdhënies teorike dhe praktike në institucionet publike të Arsimit dhe Formimit Profesional”;
- Udhezimi nr. 13, datë 1.4.2015 “Për kriteret dhe procedurat e emërimit dhe lirimit nga puna të drejtuesve të institucioneve publike ofruese të Arsimit dhe Formimit Profesional”.

Sfida është që ky kuadër ligjor të jetë funksional dhe të shmangë vështirësitë e zbatimit në praktikë.

3.2.2. Barazia Gjinore

Njohja dhe respektimi i të drejtave ligjore të barabarta ndërmjet grave dhe burrave theksohen që në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në nenin 18/2 të së cilës promovohen parimet e barazisë dhe mosdiskriminimit: “Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit dhe askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale”.

Ligji nr. 9970, datë 24.07.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri” parashikon masa të veçanta të përkohshme për të garantuar të paktën 30% pjesëmarrje të gjinisë më pak të përfaqësuar në postet politike dhe vendimmarrëse publike, si dhe mbrojtja nga diskriminimi në sektorët e arsimit, punësimit, medias, etj. Plotësimi i kuadrit nënligjor për zbatimin e këtij ligji, ndër të tjera edhe me VKM Nr. 465 datë 16.07.2012 “Për integrimin gjinor në programin buxhetor afatmesëm”, i hapi rrugën jo vetëm planifikimit të objektivave të matshme gjinore në programet buxhetore të institucioneve qendrore, por edhe të gjitha hapave të mëtejshëm në drejtim të buxhetimit të përgjigjshëm gjinor (BPGJ) në Shqipëri. Ligji nr. 221, datë 4.2.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar, ndër të tjera mbron nxënësit në sektorin e arsimit profesional nga diskriminimi për shkak të gjinisë.

3.3 Kuadri institucional

Ministria e Ekonomisë Kulturës dhe Inovacionit (MEKI) ka një rol kyç në koordinimin dhe menaxhimin e sektorit të Arsimit dhe Formimit Profesional (AFP). Përgjegjësitë kryesore të kësaj

ministrie lidhen me kuadrin ligjor dhe monitorimin e zbatimit të politikave në këtë fushë. Në këtë kontekst, MFE ka përgjegjësi të mëdha që përfshijnë sigurimin e infrastrukturës dhe burimeve njerëzore për ofruesit e shërbimeve të AFP-së. MFE është përgjegjëse për proceset e hapjes dhe mbylljes së ofruesve publikë të shërbimeve të AFP-së, duke i drejtuar në përputhje me politikat dhe rregulloret aktuale. Për më tej, ajo ka rolin e miratimit të kualifikimeve kombëtare për të siguruar nivelin e duhur të standardeve dhe kualifikimeve të ofruara në këtë sektor.

Ministria bashkëpunon ngushtë me institucione të tjera të nivelit qendror të tilla si Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS) dhe me institucionet në varësi të saj (Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar dhe Qendra e Shërbimeve Arsimore) për çështje të AFP-së, si rekrutimi dhe zhvillimi i vazhdueshëm profesional i mësuesve të lëndëve të përgjithshme ose organizimi i provimeve të maturës për nxënësit e AFP-së sekondare. Në varësi të MEKI janë dy agjenci kombëtare të cilat luajnë një rol kyç në zhvillimin, drejtimin, monitorimin dhe sigurimin e cilësisë së AFP-së.

Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve (AKAFPK) është një institucion themelor që ka detyrën e rëndësishme të koordinojë dhe menaxhojë sektorin e AFP-së. AKAFPK përgatit dhe rishikon Listën Kombëtare të Profesioneve, katalogun kombëtar të kualifikimeve profesionale dhe standardet profesionale. Kjo përfshin zhvillimin e kurrikulave të unifikuara kombëtare për ofruesit e AFP-së dhe mbështetjen e materialeve mësimore, akreditimin e ofruesve të AFP-së dhe organizimin e masave për zhvillimin e vazhdueshëm profesional për mësuesit dhe instruktorët e AFP-së. AKAFPK monitoron ofruesit publikë të AFP-së për të siguruar përputhjen me standardet kombëtare.

Agjencia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi (AKPA), e cila është ish-Shërbimi Kombëtar i Punësimin (SHPK). Asaj i është dhënë një përgjegjësi e zgjeruar me ligjin aktual për AFP-në (15/2017), e cila konsiston në mbështetjen e menaxhimit të të gjithë ofruesve publikë të AFP-së (shkollat e AFP-së dhe QFP-të) me qëllim përmirësimin e ofertës së tyre përmes monitorimit të rregullt dhe menaxhimit bazuar në rezultate. Këtu përfshihet edhe administrimi i certifikatave të AFP-së dhe gjurmimi i të diplomuarve nga AFP.

Pavarësisht koordinimit të punës mes dy agjencive ende mungojnë strukturat administrative për AFP-në në nivele rajonale.

Ndërkohë, fusha e përgjegjësisë për çështjet e barazisë gjinore i është ngarkuar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS). MSHMS ka një rol kyç në ndërtimin dhe zbatimin e politikave që promovojnë barazinë gjinore në Shqipëri. MSHMS ka detyrën të sigurojë zbatimin e ligjit, strategjisë kombëtare dhe planit të veprimit, duke respektuar detyrimet ndërkombëtare të vendit në këtë fushë. Gjithashtu, MSHMS propozon ndryshime ligjore dhe nënshkruan akte ndërkombëtare për të adresuar sfidat në barazi gjinore duke bashkëpunuar ngushtë me organizatat jofitimprurëse. MSHMS ka detyrimin të organizojë edukim dhe përgatitje për stafin e ministrisë për të trajtuar me sukses çështjet e barazisë gjinore.

Këshilli Kombëtar për Barazinë Gjinore (KKBGJ) është organi më i lartë këshillues për çështjet e barazisë gjinore dhe sigurimin e integritetit gjinor në të gjitha fushat, veçanërisht në çështjet politike, sociale, ekonomike dhe kulturore. KKBGJ i zhvillon dhe monitoron programe për të adresuar sfidat dhe për të ndihmuar në krijimin e një shoqërie ku gratë dhe burrat kanë të njëjtat mundësi dhe privilegje. Në vijim të detyrës së tij, KKBGJ përgatit dhe propozon programet kryesore që synojnë nxitjen dhe arritjen e barazisë gjinore në kontekstin e veçantë të Shqipërisë.

Organet e qeverisjes vendore luajnë një rol kyç në zbatimin e politikave për barazinë gjinore dhe bashkëpunimin me organet qendrore dhe organizatat jofitimprurëse. Organet e qeverisjes vendore kryejnë mbledhjen dhe përpunimin e statistikave vendore të ndara sipas gjinisë për të pasqyruar situatën aktuale dhe nevojat specifike të grate dhe burrat në nivel lokal. Në këtë drejtim, ato emërojnë një ose disa nëpunës vendorë të përkushtuar për çështjet e barazisë gjinore për të koordinuar veprimet dhe projektet në këtë fushë, duke siguruar një zbatim më efikas të politikave për barazi gjinore në komunitetet vendore.

3.4 Dokumentet strategjike

Në këtë seksion do t'i referohemi një analize politike të dokumenteve për barazinë gjinore, e cila ka për qëllim identifikimin dhe vlerësimin e politikave, masave dhe strategjive që janë përcaktuar në këto dokumente. Në këtë proces, është e rëndësishme të shqyrtohet konteksti politik, socikulturor dhe ekonomik në të cilin janë zhvilluar këto dokumente, duke ndihmuar në vlerësimin e tyre të efikasitetit dhe nevojave të mundshme për përmirësime.

Strategjia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive 2023-2030 është ende një draft për konsultim publik. Megjithatë, vlen të përmendet se vizioni dhe objektivat e SKPA 2023-2030 janë pjesë e rëndësishme e angazhimit të Shqipërisë për zbatimin e Agjendës 2030 dhe i shërbejnë arritjes së Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm në vend. Objektivat dhe masat e strategjisë lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me OZHQ 8 “*Promovimi i rritjes ekonomike të qëndrueshme, gjithëpërfshirëse e të qëndrueshme, punësim i plotë e produktiv dhe punë e denjë për të gjithë*”. Por njëkohësisht, zbatimi i strategjisë lidhet natyrshëm dhe me arritjen e objektivave të tjerë të rëndësishëm për Shqipërinë në kuadër të Agjendës 2030 si OZHQ 4 (arsimi), OZHQ 5 (barazia gjinore) dhe OZHQ 10 (zvogëlimi i pabarazisë).

Në SKPA 2023-2030 është identifikuar se nga anketa për arsimin e të rriturve, zhvilluar nga INSTAT-i në vitin 2017, për sa i përket gjinisë, rezultatet tregojnë se 9.5% e grave dhe 8.8% e burrave të moshës 25-64 vjeç kanë marrë pjesë në arsim dhe formim formal dhe joformal. Kjo tregon një hendek të konsiderueshëm gjinor në lidhje me pjesëmarrjen e grave në AFP.

Një tjetër dokument politik që parashikon masa për përmirësimin e situatës gjinore në sistemin e arsimit dhe aftësimit profesional është Strategjia Kombëtare për Zhvillimin dhe Integritetin 2021-2030 (SKZHI). Në listën e treguesve strategjikë të monitorimit, përkatësisht në fushën e arsimit profesional për pjesëmarrjen në %-je të grave në AFP, nga të dhënat e INSTAT për vitin 2021 identifikohet në 14,7% pjesëmarrja e grave në Arsimin Profesional. Ndërkohë për vitin 2030 është inspiruar një rritje e kësaj pjesëmarrjeje në 18%. Gjatë periudhës 2022-2023 numri i vajzave dhe

grave që frekuentojnë shkollat e AFP është rritur vetëm 1%. Si pasojë, përparësia strategjike e vendosur nga qeveria mund të konsiderohet ende ambicioze.

Strategjia Kombëtare e Rinisë dhe Plani i Veprimit 2022-2029 është një dokument i drejtpeshuar nga pikëpamja gjinore. Në raste kur pabarazia gjinore është e dukshme me masat që parashikon fuqizon rolin e vajzave dhe grave të reja. Ndër institucionet pjesëmarrëse për zbatimin e politikave dhe objektivave specifike janë MFE dhe AKAFPK sa i përket fuqizimit të të rinjve në sektorin e arsimit profesional.

Qëllimi i këtij dokumenti lidhet dhe harmonizohet me Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030 (SKBGJ), më konkretisht me objektivin specifik 1.3 për krijimin e mjedisit lehtësues dhe nxitës për përfshirjen e grave, të rejave dhe vajzave, nga të gjithë grupet (nga zonat rurale, minoritetet etnike, me aftësi të kufizuara, LGBTI+, të moshuara, nëna të vetme, të mbijetuara të dhunës/trafikimit, vajza nëna, migrante dhe azilkërkuese, etj.), në punë të denjë edhe në sektorët jo-tradicionale. Një nga masat dhe aktivitetet e parashikuara për sektorin e arsimit profesional është *përgatitja e fletëpalosjeve/broshurave informuese mbi rëndësinë dhe mundësitë e ofruara nga AFP dhe të nxëniet gjatë gjithë jetës për vajzat, djemtë, të rejat, të rinjtë, gratë dhe burrat në zonat urbane dhe rurale (siç parashikohet edhe në SKP 2019-2022, tek masat nën B6)*

Programi i Qeverisë 2021-2025 në shtyllën 4 të tij na prezanton familjen si themeli ku ndërtojmë të ardhmen. Në të përfshihet shoqëria e dijes për një Shqipëri të fortë, e cila është shtylla ku ne mbështetemi për të përmirësuar sektorin e arsimit profesional. Plani i Qeverisë konsiston në zhvillimin e sistemit arsimor, ku shkollat profesionale janë përparësi, të cilat do të përgatisin qytetarin e mirë dhe punonjësin e suksesshëm të vitit 2030-të, duke pajisur studentët shqiptarë me dije dhe aftësi të konkurrueshme me bashkëmoshatarët e tyre në BE.

Me rëndësi është lidhja me Planin Kombëtar të Integritimit Evropian 2022-2024 (PKIE) dhe Acquis të BE-së, konkretisht me dy kapituj kryesorë të PKIE 2022-2024, me **kapitullin 19 “Politika sociale dhe punësimi”**, si dhe me **kapitullin 26: “Arsimi dhe Kultura”**. Acquis në fushën e politikës sociale përfshin standarde minimale në fusha si, ligji i punësimit, trajtimi i barabartë i grave dhe burrave në punësim dhe politika sociale, shëndeti dhe siguria nëpunë, mosdiskriminimi në punësim dhe politika sociale, gjithashtu në përfshirje sociale dhe mbrojtje. Detyrimi për të përafëruar legjislacionin shqiptar në arsim me acquis të BE-s buron nga neni 70 i MSA-së për përafërimin e legjislacionit dhe neni 100 lidhur me përafërimin e legjislacionit në arsim dhe formim. Të dhenat tregojnë se *nëpërmjet qendrave publike të formimit profesional janë ofruar kurse formimi sipas kërkesave të tregut të punës. Për periudhën janar – gusht të viti 2021 janë regjistruar 6 246 persona, prej të cilëve 2 747 femra, ndërsa janë certifikuarit rreth 2 614 persona, nga të cilët 1 157 janë femra*. Në këtë dokument, del në pah edhe një herë hendeku gjinor në pjesëmarrjen e vajzave dhe grave në arsimin profesional.

Qëllimi i këtij dokumenti ka nje lidhje akoma më të ngushtë me Objektivat e Zhvillimit të Qendrueshëm (OZHQ) dhe Axhendën 2030. Në mënyrë specifike, ky dokument politikash lidhet me OZHQ 4 dhe OZHQ 5.

Republika e Shqipërisë ka paraqitur në Komitetin për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave (Komiteti CEDAW) Raportin e Pestë Kombëtar Periodik mbi zbatimin e Konventës për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave⁷. Ky raport, i paraqitur sipas nenit 18 të Konventës për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave, mbulon periudhën ndërmjet korrikut 2016 dhe shtatorit 2020. Raporti përmban informacion mbi zbatimin e dispozitave të Konventës dhe rekomandimeve të Komisionit, bazuar në vërejtjet përfundimtare.

Për sa i përket aspektit gjinor në sistemin arsimor profesional, sipas këtij raporti del në pah se 14 përqind e nxënësve të regjistruar në shkollat e mesme profesionale në të gjithë vendin në vitet 2017–2018 i përkasin gjinisë femërore, ndërsa pjesa tjetër e nxënësve i përkasin gjinisë mashkullore. Kjo tregon një pjesëmarrje të ulët të numrit të vajzave në shkollat e mesme profesionale të cilat nuk përshtaten dhe nuk i shfrytëzojnë mundësitë dhe programet mësimore që këto programe mësimore ofrojnë.

⁷ Raporti i pestë periodik i paraqitur nga Shqipëria në bazë të nenit 18 të Konventës që pritet në vitin 2020, Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave.

IV. ANALIZA E KURRIKULËS DHE FOKUS GRUPET

Sikurse u përmend dhe më herët, në kuadër të përgatitjes së këtij dokumenti politikash, Qendra ka analizuar kurrikulën e lëndës së letërsisë, gjuhës shqipe dhe historisë në lëndën gjinore, si dhe ka organizuar takime/fokus grupe me 36 mësues nga 5 shkolla profesionale në nivel vendi.

Marrëveshjet e shumta ndërkombëtare, përfshirë Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG), Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit (OZHM) dhe Arsimi për të Gjithë (EFA) kanë theksuar rëndësinë e arritjes së barazisë gjinore në arsim. Deri më sot, këto qëllime janë përqendruar kryesisht në arritjen e barazisë gjinore në raport me regjistrimet (d.m.th., sigurimin e aksesit dhe pjesëmarrjes së barabartë në arsim për djemtë dhe vajzat) dhe rritjen e cilësisë së arsimit për të gjithë nxënësit (d.m.th., sigurimin e arritjeve të barabarta akademike midis djemve dhe vajzave).

Sidoqoftë, vetëm regjistrimi në shkollë dhe arritjet akademike nuk garantojnë barazi gjinore. Në fakt, raporti i OECD⁸, tregoi se barazia gjinore dhe fuqizimi i grave kanë mbetur ende “punë e papërfunduar” në të gjitha vendet. Në shumë vende të OECD dhe ekonomitë në zhvillim, përfshirë Shqipërinë, gratë kanë ende më pak gjasa të përfaqësohen në politikë, marrin pjesë më pak në fuqinë punëtore, përqendrohen në sektorë ekonomikë me pagë më të ulët dhe fitojnë më pak se burrat. Siç vëren Longwe⁹, kjo ndodh sepse shkollat përjetësojnë, qoftë në mënyrë të drejtëpërdrejtë apo pa dashje pabarazitë gjinore përmes marrëdhënieve të pushtetit, pedagogjisë dhe portretizimit stereotipik të roleve të burrave dhe grave në tekstet shkollore, kurrikulat dhe materialet mësimore.

Rolet gjinore nuk janë të gdhendura në gur. Çdo shoqëri, grup etnik dhe kulturë ka pritshmëritë e veta në lidhje me rolin gjinor, por ato mund të jenë shumë të ndryshme nga grupi në grup. Ata gjithashtu mund të ndryshojnë në të njëjtën shoqëri me kalimin e kohës. Është shoqëria ajo që përcakton që ne të perceptojmë profesionin e “mësueses”, “infirmieres” si një profesion për gratë ndërsa profesionin e “pilotit”, “policit” ose “inxhinierit” si punë të burrave. Sidoqoftë, aftësitë e mira profesionale duhet të jenë rrjedhojë e edukimit, trajnimit dhe praktikës, pavarësisht gjinisë. E njëjta vlen edhe për punët e shtëpisë: gatimi i ushqimit të shijshëm ose kujdesi për fëmijët nuk përcaktohen gjenetikisht, dhe mund të bëhen si nga burrat dhe nga gratë. Por, sipas roleve gjinore, në shumë shoqëri, gratë kufizohen brenda rolit shtëpiak përkujdesës, ndërsa burrat tek roli drejtues e prodhues.

Stereotipet gjinore mund të shkaktojnë trajtim të pabarabartë dhe të padrejtë dhe të çojnë në përdorimin e gjuhës së urrejtjes dhe forma të tjera të diskriminimit me bazë gjinore, siç është seksizmi. Këshilli i Evropës miratoi në vitin 2019 përkufizimin e parë të pranuar ndërkombëtarisht

⁸ OECD report Closing the Gender Gap: Act Now (2013)

⁹ Longwe, S. H. (1998). Education for women's empowerment or schooling for women's subordination. Gender and Development, 6(2), 19–26.

të seksizmit: “një manifestim i marrëdhënieve historikisht të pabarabarta të pushtetit midis grave dhe burrave, i cili çon në diskriminim dhe parandalon përparimin e plotë të grave në shoqëri”.¹⁰ Qasja e integritetit gjinor synohet si një proces transformues në fusha të shumta, duke përfshirë faktorët sociokulturorë, ekonomikë dhe institucionalë.¹¹ Ndikimi i përpjekjeve të integritetit gjinor mund të jetë thelbësor vetëm nëse zbatohet në mënyrë sistematike. Në fushën e arsimit, kjo nënkupton një angazhim për zhvillimin dhe zbatimin e politikave të ndjeshme ndaj gjinisë, kurrikulave, teksteve shkollorë, trajnimit të mësuesve dhe kulturës së përgjithshme të shkollës me qëllim të transformimit rrënjësor të normave dhe vlerave shoqërore që përjetësojnë diskriminimin. Studimet theksojnë se edukimi i fëmijërisë së hershme luan një rol qendror në formimin e stereotipave dhe paragjyqimeve me bazë gjinore, i cili çon më pas në diskriminim me bazë gjinore.

Sistemi arsimor mund të luajë një rol të rëndësishëm në hedhjen poshtë të stereotipave ekzistuese, paragjyqimeve dhe edukimin e qytetarëve/eve të ardhshëm/e të cilëve/at më pas do të krijojnë politika të ndjeshme gjinore. Integriteti i perspektivës gjinore në zhvillimin e kurrikulave dhe librave shkollorë është një parakusht për të pasur një shoqëri më të barabartë.

Analiza gjinore e kurrikulës u bazua në një shqyrtim të detajuar të disa teksteve në të gjitha vitet e arsimit parauniversitar (lista e detajuar e teksteve gjendet në Shtojcën 1). Siç është sipërpërmendur, elementët kryesorë të këtij shqyrtimi ishin prania e parimeve të barazisë gjinore në tekste, prania e stereotipeve gjinore tradicionale, përfaqësimi i grave dhe burrave në këto tekste, si dhe përbërja e grupit të autorëve/eve.

Duke filluar nga përbërja e autorëve/eve, mund të thuhet se ka një ***prani të ekuilibruar të eksperëve/eve burra dhe gra***, qoftë në totalin e autorëve për tekstet e shqyrtuara, qoftë dhe në lidhje me çdo tekst në veçanti.

Një element i rëndësishëm për t’u përmendur këtu është gjuha e përdorur. Ashtu si dhe në vende të tjera, ***përdorimi i gjuhës mashkullore si gjuhë standarte duhet të jetë një pikë e rëndësishme diskutimi për t’u ndryshuar***. Duke përdorur vetëm format mashkullore sidomos për profesionet e ndryshme veçanërisht në nivel drejtues, krijohet përshtypja, në mënyrë të pandërgjegjshme se këto profesione mund të jenë vetëm për burrat dhe se gratë praktikisht nuk ekzistojnë në sferën jashtë shtëpisë.

Pavarësisht rëndësisë që ka ***përfshirja e perspektivës gjinore në tekstet shkollorë***, këto tekste ende paraqesin mangësi në këtë drejtim. Elementët e parimeve bazë të barazisë gjinore janë ende shumë të pakta ose mungojnë edhe në ato tekste ku do të mund të përfshiheshin me lehtësi si gjuha ose letërsia. Mungojnë shtjellimet e elementëve të barazisë gjinore në lidhje me të drejtat e grave dhe burrave, e ligjeve mbi barazinë gjinore dhe kundër dhunës, e shtjellimit të fenomenit të dhunës me bazë gjinore, ose të pabarzive gjinore.

¹⁰ Këshilli i Evropës, Rekomandimi CM / Rec (2019) 1 për Parandalimin dhe Luftimin e Seksizmit, miratuar nga Komiteti i Ministrave në 27 Mars 2019: <https://rm.coe.int/168094d894>

¹¹ (McCracken et al., 2015).

Një element tjetër i përbashkët i këtyre teksteve është *mungesa e figurave femërore qoftë në letërsi apo dhe si shembuj suksesi*. Në lidhje me këtë të fundit, shumica dërrmuese e shembujve të suksesit në fusha të ndryshme janë personazhet burra (sport, politikë, muzikë, etj). Gjithashtu, vërehet mungesë e autoreve gra të letërsisë bashkohore si Simone de Beauvoir, Virginia Wolf etj.

Ajo që vihet re shpesh në tekstet shkollore, është një *përforcim i stereotipeve gjinore ekzistuese në shoqëri, të cilat i atribuojnë grave dhe burrave role të ndryshme shoqërore*, duke i kufizuar gratë ose brenda shtëpisë ose në ato role që kërkojnë dhembshuri dhe sakrificë, ndërkohë që burrat kanë rolet drejtuese, trimërore, më të rëndësishme, shpëtimatare. Në vazhden e këtyre stereotipeve, gratë paraqiten si të fokusuar tek pamja dhe jo tek thelbi, dhe të kufizuara në rolet “e bindura” dhe jo vendimmarrëse. Do të ishte shumë e rëndësishme, që dhe kur përdoren elementë të kulturës popullore apo të historisë që shpërfaqin këto stereotipe, tekstet dhe mësuesit të mund të pasonin me një analizë kritike duke shpjeguar pasojat e këtyre stereotipeve në vendosjen e grave në role dytësore.

Përpos analizës së një pjese të kurrikulës të programit të përgjithshëm në arsimin profesional, puna vijoi me organizimin e dy fokus grupeve me shkolla në rang vendi. Shkollat e përfshira në këtë analizë janë:

1. Shkolla Teknike Ekonomike Tiranë
2. Shkolla Profesionale Teknike Korçë
3. Shkolla e Mesme Profesionale “Thoma Papapano” Gjirokastrë
4. Shkolla Profesionale “Telford Erikson”, Golem
5. Shkolla e Mesme Profesionale “Stiliano Bandilli”, Berat.

Dy fokus grupet online me mësues të këtyre shkollave kishin për qëllim identifikimin dhe dakordësimin e përbashkët të çështjeve dhe nevojave në këtë sektor si dhe diskutimin e gjetjeve dhe rekomandimeve të nxjerra nga kurrikula. Gjatë dy takimeve të mësipërme u diskutua mbi analizën gjinore të kurrikulës, e cila është bazuar në një shqyrtim të detajuar duke përdorur një kampion përfaqësues prej 8 tekstesh shkollore për nivelin 10-11-12 duke parë përbërjen gjinore të grupeve të autorëve të këtyre teksteve në të gjitha vitet e arsimit parauniversitar.

Ndër të tjera, elementët kryesorë të këtij shqyrtimi ishin prania e parimeve të barazisë gjinore në tekste, prania e stereotipeve gjinore tradicionale, përfaqësimi i grave dhe burrave në këto tekste si dhe përbërja e grupit të autorëve/eve. Pas diskutimeve të mësipërme nga grupi i punës u ftuan mësuesit për të dhënë mendimet e tyre lidhur me kurrikulën shkollore. Mësuesit u shprehën se, **shkollat profesionale në vetvete shihen me skepticizëm që në momentin e aplikimit, pasi trajtohen si shkolla që mund të frekuentohen nga nxënës me performancë arsimore të ulët, ku regjistrohen më tepër djem, sidomos profilet e TIK, Mekanikës, Hidraulik etj.**

Disa mësues vërejtën, ata **me iniciativën e tyre mundohen që të trajtojnë tema që lidhen me barazinë gjinore**. Ndërkohë, sa i përket kurrikulës, **mjaft tekste shfaqin problematikën e**

stereotipeve gjinore të cilat evidentohen dhe përmes ilustrimeve p.sh., në rolin e të bukurës, vendosen vajza/gra ndërsa në rolin e shkencëtarëve vendosen figura të djemve/burrave, duke përforcuar në këtë mënyrë stereotipet gjinore.

Një nga sugjerimet që doli si pikë e përbashkët për 5 shkollat pjesëmarrëse ishte pasja e një **kurrikule më specifike për lëndët e arsimit të përgjithshëm në Arsimin Profesional, duke qenë se dhe orët për lëndët e përgjithshme janë më të reduktuara.** Nevoja lind dhe për shtimin e kurrikulës shkollore të lëndëve të përgjithshme për klasat e 13-ta në shkollat e mesme profesionale, e cila të kishte në vëmendje lënten gjinore që në momentin e parë të hartimit. Diskutime pati për sa i përket **shtimit të autoreve gra, të huaja dhe shqiptare me qëllim sjelljen në vëmendje dhe perspektivës letrare sjellë nga pikëpamjet e një gruaje.** Ky propozim, i cili u vlerësua si tepër i rëndësishëm për arsimin profesional me qëllim sfidimin e stereotipeve gjinore, u soll me shembuj për përfshirjen e autoreve si Jane Austin, Virginia Wolf, Simone de Beauvoir, Maya Angelou, Sylvia Plath, Flutura Aça, Elvira Dones, Diana Çuli, Musine Kokalari, Sabiah Kasimati (si shkencëtare) etj.

Gjithashtu, si pjesë të aktiviteteve Qendra kishte dhe zhvillimin e dy takimeve strategjike me Institucione relevante të fushës. Në takimin strategjik të mbajtur pranë AKPA, Znj. Gjelaç na informoi se ka pasur një mungesë në kurrikulën e shkollave profesionale për klasën e 13-të, por vuri në dukje se viti i ri shkollor 2024-2025, do të kemi ndryshime të kurrikulës. Gjithashtu, ka një mungesë të librave që lidhen me formimin profesional në këto shkolla, pasi të gjitha informacionet mbi profesionet dhe materialet me të cilat nxënësit duhet të punojnë merren online. Një problematikë tjetër me të cilin përballen shkollat profesionale në Shqipëri, lidhen me stereotipet e profesionit. Në pamundësi të ndryshimit 100% të këtyre stereotipeve, fokusi i shkollave profesionale është që **të nxisin vajzat për t'u bërë pjesë e tyre nëpërmjet aftësive të buta.**

Takimi i radhës u mbajt pranë Ministrisë së Shtetit për të rinjtë dhe Fëmijët, ku znj. Sala, shfaqti vullnetin për ta përcjellë këtë dokument pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit si dhe **diskutimi i tij me grupet e përbashkëta të punës për shqyrtimin e problematikave që hasin shkollat profesionale në Shqipëri, për sa i përket teksteve të arsimit të përgjithshëm.** Gjithashtu, bazuar në këtë dokument, znj. Sala do të zhvillonte një tryezë diskutimi me Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, për ndryshim e kurrikulës së arsimit të përgjithshëm për shkollat profesionale.

V. GJETJET KRYESORE

- Një prani të ekuilibruar të eksperë/eve burra dhe gra, qoftë në totalin e autorëve për tekstet e shqyrtuara, qoftë dhe në lidhje me çdo tekst në veçanti.
- Përdorimi i gjuhës mashkullore si gjuhë standarte duhet të jetë një pikë e rëndësishme diskutimi për t'u ndryshuar.
- Elementët e parimeve bazë të barazisë gjinore janë ende shumë të pakta ose mungojnë - shtjellimet e të drejtave të grave dhe burrave, e ligjeve mbi barazinë gjinore dhe kundër dhunës, fenomeni i dhunës me bazë gjinore, ose të pabarazive gjinore.
- Mungojnë figurat femërore qoftë në letërsi apo dhe si shembuj suksesi.
- Vihet re përforcim i stereotipeve gjinore ekzistuese në shoqëri, të cilat i atribuojnë grave dhe burrave role të ndryshme shoqërore.
- Shkollat profesionale trajtohen si shkolla që mund të frekuentohen nga nxënës me performancë arsimore të ulët, ku regjistrohen më tepër djem, sidomos profilet e TIK, Mekanikës, Hidraulik etj.
- Mungon kurrikula shkollore të lëndëve të përgjithshme për klasat e 13 në shkollat e mesme profesionale.

VI. REKOMANDIME

- Në vizionin e shkollave profesionale për të ardhmen, synimi kryesor duhet të jetë **krijimi i një mjedisi të avancuar arsimor dhe shoqëror**, ku shquhet respekti dhe përkrahja për të gjithë nxënësit, pavarësisht gjinisë. Këto institucione duhet të përqendrohen në promovimin e lirisë së mendimit, ndërgjegjes, fesë dhe besimit, duke ndërtuar një kulturë të barabartë dhe inkurajuese.
- Shkollat profesionale duhet të kenë një **rol aktiv në krijimin e imazheve jo-stereotipe** për gratë dhe burrat, duke ndihmuar në shkatërrimin e paragjytimeve dhe ndërprerjen e shfrytëzimit të stereotipeve gjinore. Në këtë kontekst, duhet të fokusohen në krijimin e programeve dhe aktiviteteve që inkurajojnë dhe ndihmojnë të rinjtë dhe të rejtat të identifikojnë dhe zhvillojnë pasionet dhe aftësitë e tyre, duke i bërë ata të ndjehen të lirë të ndjekin rrugën e tyre të zgjedhur.
- Përmes përdorimit të teknologjisë, metodave mësimore inovative dhe bashkëpunimit me komunitetin dhe industrinë, shkollat profesionale mund të **ndërtojnë një mjedis të pasur dhe të përshtatshëm për të gjithë nxënësit**. Duke thelluar këtë angazhim, ato do të jenë forcë e udhëheqjes në shpalljen e një arsimit të barabartë dhe të drejtë, duke siguruar se të gjithë nxënësit kanë mundësinë të zhvillojnë potencialin e tyre të plotë, pavarësisht gjinisë.
- **Hartimi i një kurrikule të dedikuar për programin e përgjithshëm në arsimin profesional** do të adresonte një nevojë aktuale që ky sistem has.
- Barazia gjinore në arsimin profesional është një sfidë dhe një synim që kërkon përkushtim dhe ndryshime thelbësore në strukturat dhe praktikën e arsimit. Në këtë kontekst, **përfshirja e temave të barazisë gjinore në kurrikulat** dhe materialet mësimore të arsimit profesional është jetësore për të kultivuar një mjedis ku të gjitha individët kanë mundësinë e barabartë për të zhvilluar aftësitë dhe përparuar në karrierë. Zhvillimi i këtyre praktikave mund të ndihmojë në ndryshimin e normave shoqërore, duke thelluar kuptimin dhe vlerësimin e barazisë gjinore.

Në mbështetje të sa më sipër cituar, në vijim do të paraqiten disa aktivitete me rëndësi:

1. Integrimi i Barazisë Gjinore në Kurrikula:

- **Zhvillimi i Kurrikulave me Perspektivë Gjinore:** Hartimi i kurrikulave që pasqyrojnë shembujt dhe kontributet e të dy gjinive në fushat profesionale. Kjo përfshin shembuj të suksesshëm të grave dhe burrave në profesione të ndryshme.
- **Trajnim i Mësuesve:** Sigurimi që mësuesit dhe instruktoret e arsimit profesional janë të trajnuar për të trajtuar çështjet e barazisë gjinore dhe për të ndihmuar në formimin e një kulture të respektit dhe barazisë në klasë dhe laborator. Kjo mund të përfshijë trajnime dhe seminare periodike për përditësimin e tyre.

2. Hartimi dhe Zbatimi i Materialeve me Perspektivë Gjinore:

- **Analiza e Materialeve Ekzistuese:** Identifikimi dhe rishikimi i materialeve mësimore aktuale që mund të përmbajnë stereotipe gjinore apo të mos përfshijnë perspektivën e barazisë gjinore. Rregullimi dhe përmirësimi i tyre kur është e nevojshme.
- **Bashkëpunimi me Industrinë dhe Sektorin Privat:** Inkurajimi i bashkëpunimit me kompanitë dhe organizatat e industrisë për të siguruar që materiale shkollore reflektojnë realitetin e përditshëm të profesioneve dhe mundësive për të gjitha gjinitë. Incentivizimi i autorëve dhe botuesve të materialeve shkollore për të përfshirë një perspektivë gjinore.

3. Monitorimi dhe Vlerësimi i Zbatimit:

- **Krijimi i Mekanizmave të Monitorimit:** Ndërtimi i një sistemi të qëndrueshëm për të monitoruar se si po zbatohet barazia gjinore në kurrikula dhe materiale shkollore, si dhe për të ndjekur progresin në adresimin e çështjeve gjinore në arsimin profesional. Kjo përfshin anketime periodike, vlerësime nga mësuesit dhe rishikime periodike.
- **Feedback nga Nxënësit:** Inkurajimi i nxënësve për të ndarë pikëpamjet e tyre (perceptimet dhe përvojat) dhe për të dhënë feedback lidhur me mësimet dhe materialet shkollore. Kjo mund të ndihmojë në përmirësimin e strategjive dhe kurrikulave.

4. Përbushja e Objektivave Edukative:

- **Ndërthurja e Perspektivës Gjinore me Qëllimet Edukative:** Sigurimi që materialet shkollore dhe mësimdhënia me perspektivë gjinore përmbushin objektivat edukative duke përfshirë zhvillimin e kritikës, ndërgjegjësimin dhe aftësimin e nxënësve. Trajnimet profesionale duhet të kujdesen për promovimin e karrierave tradicionalisht të lidhura me një gjinë të caktuar.
- **Mbështetje për Studentët dhe Këshillimi i Karrierës:** Mundësimi i studentëve për të zgjedhur dhe ndjekur karrierën e tyre pa bërë asnjë diskriminim bazuar në gjini. Ofrimi i këshillimit të karrierës që reflekton mundësitë e të dy gjinive.

Përmes këtyre përpjekjeve, arsimi profesional mund të kontribuojë aktivisht në ndryshimin e paradigmave, në ndërtimin e një mjedisi të barabartë dhe inkurajues për të dyja gjinitë, dhe në përgatitjen e një brezi të ri të punësuarish me një vështrim të barabartë ndaj mundësive dhe sfidave në botën e punës, me vlera të përbashkëta të barazisë gjinore dhe respektit për diversitetin.

SHTOJCA - ANALIZA GJINORE E TEKSTEVE SHKOLLORE TË ARSIMIT TË PËRGJITHSHËM NË ARSIMIN DHE FORMIMIN PROFESIONAL

Tematika	Temat
Qytetaria: Klasa e 10-të: Autorët/et: Klodiana Beshku, Oltion Spiro, Gentiana Qirjako, Brunilda Zenelaga. Shtëpia Botuese: PEGI	
Ligji	<p>Tema 1: Ligji dh funksionet e tij - Në këtë mësim thuhet se filozofët janë munduar të gjejnë mënyrën më të mirë të rregullimit të bashkëjetesës njerëzore, me qëllim që të ndërtohen shoqëri të drejta dhe të lumtura. Dhe të gjithë filozofët e përmendur në tekst janë të gjinisë mashkullore.</p> <p>Tema 2: Rëndësia e ligjit në shoqëri - Në këtë mësim vihet re përdorimi i fjalëve “qytetar”, “politikanë”, “nënpunës”, “më i privilegjuari”, etj., të gjithë emra të përdorur vetëm në gjininë mashkullore.</p>
Kushtetuta e Shqipërisë	<p>Tema 1: Çfarë është Kushtetuta? – Edhe pse në ilustrimin e çështjes për diskutim janë të ilustruar një vajzë dhe një djalë, në tekst edhe pse kuptohet që në skuadër ka të rinj dhe të reja, përdoret vetëm fjala “të rinj”. (fq. 23)</p> <p>Tema 2: Kushtetuta dhe organet e shtetit – Të gjithë pozicionet e larta në këtë mësim iu referohen meshkujve, “<i>Presidenti, Kryeministri, Kryetari i Qeverisë, deputetët</i>”. Kur lexojmë këtë nuk kujtojmë se të gjithë këta janë vetëm meshkuj; përkundrazi, ne e dimë që pjesëmarrja e grave dhe vajzave në këto pozicione është e lartë. Ndoshta kjo përshtatje në gjininë mashkullore si një formë e përfshirjes dhe të gjinisë tjetër është tregues, pasojë por edhe shkak i vendit dytësor që i është dhënë gruas në shoqëritë patriarkale dhe rrjedhimisht dhe në gjuhë.</p> <p>Tematika 4 – Arsimimi</p> <p>Tema 1: Shkolla dhe arsimimi, si të drejta themelore – Vihet re përdorimi i takteve me emra vetëm në gjininë mashkullore, që të japin përshtypjen e njëanshmërisë së djemve në krahasim me vajzat. Konkretisht në një paragraf citohet: “Në shoqëritë demokratike, nxënësit dhe studentët me rezultate të larta, zakonisht kanë më shumë mundësi të sigurojnë pozita ekonomike e shoqërore më të privileguara.” (fq. 59)</p>
Shëndeti	Në këtë mësim vihet re përdorimi i gjinisë mashkullore për të treguar profesione të ndryshme që mund të jenë edhe gra, p.sh.: punonjësit shëndetësorë, profesionistët e medias, etj.
Konsumatori	I gjithë kapitulli fillon me këtë emër në gjininë mashkullore.
Bashkëjetesa në Komunitet	Mësimi 3: Të drejtat dhe detyrimet e përbashkëta në komunitet – Në nën çështjen “Vështirësitë e përmbushjes së detyrimeve të përbashkëta”, autori/ja ka zgjedhur të ilustrojë me foton e një nëne që po ecën vetëm me karrocën e fëmijës dhe çantë në supe, si për të treguar që gruaja ka për detyrim të rrisë dhe kujdeset për fëmijët ndërkohë që burri nuk duket prezent.
Letërisa: Klasa e 10-të Autorët/et: Sabri Hamiti, Ardian Marashi, Dhurata Shehri; Shtëpia botuese: Albas	
	Libri ka në përmbajtjen e tij kryesisht autorë burra, me përjashtim të një autoreje grua që i përket mitologjisë [Poetsha Safo]. Mund të ketë një nxitje për nxënësit që figurat

	<p>mitiologjike ti sjellin dhe në kontekstin e ditëve të sotme, parë dhe me një sy pak më kritik - kjo mund të bëhet gjatë orëve ekstrakurrikulare].</p>
	<p>Teksti i referohet gjinisë mashkullore “nxënësi”, "autorë" "autorin" ose “lexuesit” (Fq. 3);</p> <p>Evidentimi “nxënësi/ja” ose “nxënësin/sen”. (Fq. 4)</p> <p>Nxënësve duhet shtuar <i>nxënëseve</i>. Më tej e specifikon nxënësi/sja, nxënësit/es. (Fq. 5)</p> <p>Përmendet <i>shkrimtari, lexuesi, lexues, secili, autori</i>. Vepra letrare është objekt gjykimi i <i>lexuesit, studiuesit ose kritikut</i>. Duhet ashtuar dhe gjinia femërore) (fq. 8)</p> <p>- Shpeshherë <i>shkrimtari, regjisorin e skenaristit</i> janë i njëjti person . Cili është <i>autori</i> juaj më i pëlqyer në letërsinë shqiptare dhe në atë botërore? Mund të ishte (<i>Cili/la është autori/ja juaj më i/e pëlqyer...?</i>); (Fq. 10)</p> <p>Pyetja 7 - <i>lexuesit/es</i>; Pyetja 10 - Ç’ pozicion ka kritika në raport me veprën dhe <i>lexuesin/en?</i>; (Fq. 11)</p> <p>- <i>Protagonisti</i>, i cili është <i>personazhi</i> më i rëndësishëm i tregimit, që zë vend gati në të gjithë paragrafët rrëfyës. Edhe kur nuk ndodhet i pranishëm, ai është në qendër të rrëfimit. Zakonisht luan dhe rolin e zëdhënësit të autorit, për të shprehur mendimet dhe ndjesitë e tij. (Fq. 15)</p> <p>(Sipas funksionit personazhet ndahen në: <i>Protagonist (ose heroi)</i>, është personazhi kryesor i tregimit, rreth të cilit zhvillohet e gjithë ngjarja; në më të shumtën e rasteve është vetëm një, por ndonjëherë e ndan rolin e tij me një apo me më shumë personazhe kryesore. <i>Antagonist</i>, është <i>personazhi</i>, zakonisht i keq, që ka rolin të kundërshtojë protagonistin, për ta penguar të arrijë atë që ai dëshiron. <i>Ndihmës</i>, është personazhi që ka rolin të qëndrojë pranë e të ndihmojë protagonistin. Ndihmësit mund të jenë edhe më shumë se një. <i>Protagonisti</i> duhet të ruhet nga ndihmësit falsë, pra nga personazhet që pretendojnë se duan ta ndihmojnë, por ama nuk e bëjnë këtë gjë. (Fq. 15)</p> <p>E ka respektuar <i>autori</i> në rrëfimin... si e ka zbatuar <i>autori</i> këtë gërshetim... autori mund t’i bëjë të zgjatin sa të dojë... përse <i>autori</i> ka zgjedhur ta vendosë historinë e tij në këtë vend e jo në një tjetër. [Duhet përdorur dhe gjinia femërore kur i referohemi protagonistit pasi mund të jetë dhe protagonistja, ose heroina,, antagonistja e kështu me radhë). (Fq. 16)</p> <p>- <i>Rrëfimtari ... 1</i>. Rrëfimtari mund të hyjë në rrëfim... Rrëfimtari mund të qëndrojë jashtë historisë; Në ndonjë rast autori, pasi ka ndenjur i fshehur për pak; Për të rrëfyer një ngjarje autori përdor mjetin gjuhësor, pra, kodin-gjuhë. <i>Shkrimtari</i> i shfrytëzon mjetet stilistike për ta bërë shkrimin e tij më të qartë; (Të përdoret edhe rrëfimtari ose shkrimtari) (Fq. 17)</p> <p><i>Autori/ja...; Rrëfyesi/ja</i>; (Fq. 18); <i>Poeti/ja</i>; (Fq. 19)</p> <p>- <i>Heroi/na</i>; (Fq. 26) Martesa e Halilit, Gjergj Eleza Alia. Mund të përdoren dhe legjenda të tjera që sjellin më shumë në vëmendje gratë dhe vajzat. (Fq. 20)</p> <p>- Pyetja 11 - Cili është ai <i>autor</i> i letërsisë shqiptare, që ka shkruar më shumë fabula alegorike? <i>Ka ndonjë autore shqiptare? - Mund të jetë një pyetje që ngacmon</i>. (Fq. 31)</p> <p>- Poetessa SAFO: Autore e antikitetit e sjellë në këtë libër (tregon një vlerë të shtuar dhe sjell në vëmendje dhe rëndësinë e grave si autore); (Fq. 46)</p> <p>- E Bukura e Dheut, Floçka, Qerosi etj., dhe personazhe me domethënie të keqe, negative: Shtriga, Lubia, Syqenëza, Qosja etj. Përrallat shqiptare janë të pasura me figura të</p>

mitologjisë shqiptare, si: Orët, Zanat, Shtojzovallet, Gërzheta etj. Këto personazhe femra shpesh kanë cilësi të njëjta, që lidhen me bukurinë e tyre fantastike dhe me mjediset e jashtëzakonshme ku jetojnë. Mund edhe ti flisnim më tepër këto përralla parë në lentin gjinore? (Fq. 93)

- Balda: Mund të shihen në lentin gjinore. Trajtim nga ana e mësuesve duke e vendosur në kontekstin e ditëve të sotme. Rozafati - Dhembshuria e nënës; Kostandini - Besa e dhënë... (Fq. 100)

- Forca e Mujit është dhuratë e zanave, të cilat ai i thërret në ndihmë sa herë ndihet ngushtë. Zanat banojnë thellë në pyje, pranë burimeve; kanë pamjen e një gruaje ngashënjyese, vështrimi i së cilës shiton ose nguros edhe më trimat. Prandaj njerëzit i adhurojnë zanat e njëkohësisht ua kanë frikën. *Orët* janë krijesa po aq të çuditshme e të pakapshme si zanat. Orët kanë në dorë fatin e heronjve, të fiseve e të krahinës. Çdo hero i lutet orës së vet, madje kjo mund të ndeshet në luftë me orën e kundërshtarit. Orët janë nazike e hatërmëdha, ndaj populli i quan me eufemizëm shtojzovalle (shtoi Zot vallet) ose të lumet. [*Trajtimi i figurave mitologjike duhet parë dhe në lentin gjinore.*](Fq. 110) Përshirja e autoreve gra do të ishte një vlerë e shtuar, për të prezantuar të rinjtë me autorë të gjinisë femërore.

Historia: Klasa e 10-të; **Autorët/et:** Romeo Guakuqi, Paulina Hoxha (Kabashi), Anila Beshaj, Petrika Thëngjilli, Andi Pinari; **Shtëpia Botuese:** PEGI

1. Në këtë libër trajtohet historia që nga qytetërimi antik grek e romak e deri tek qytetërimet bashkëkohore. Ajo që vihet re është mungesa përmendjes së grave, apo trajtimi në mënyrë të cunguar i rolit të tyre në histori.

Për shembull:

- Mbretëresha Elisabeta I përmendet vetëm në kllapa dhe me një figurë ilustruese përkatësisht në fjalinë: “Dinastia e Tudorëve, me origjinë uellsiane, ka pasur *tre mbretër* (Henriku VII, Henriku VIII dhe Elisabeta I), që kanë luajtur një rol të rëndësishëm në shndërrimin e Anglisë në një shtet të fuqishëm. Është përdorur fjala mbretër, ndërkohë që në këtë rast ka edhe një mbretëreshë. (fq. 45) Ndërkohë që po në të njëjtin mësim, psh. Mbreti Xhon pa Tokë, trajtohet në një çështje të dedikuar rreth një faqe dhe ilustruhet edhe me foto. (fq. 44)

- Elisabeta I trajtohet edhe më vonë (fq. 82), por përsëri hapësira që i jepet është shumë e cunguar, edhe pse edhe në tekst shpjegohet se ajo ishte një mbretëreshë e rëndësishme në historinë e Anglisë.

- Në rastin e Katerinës së Madhe (fq. 77) ku kemi një shpjegim më të detajuar për sundimin e një mbretëreshë, vihen re fjalitë “*Katerina ishte një pasuese e denjë e Pjetrit të Madh në politikën e shtrirjes territoriale në...*” dhe vijon edhe në fjalinë pasuese “*Sikurse edhe Pjetri i madh, ajo dëshironte të kishte porte detare më të ngrohta për Rusinë...*”, pra edhe në këtë rast kur flitet për një mbretëreshë të suksesshme në kohën e të cilës shoqëria dhe kultura u zhvilluan shumë, madje Rusia në këtë periudhë ishte një fuqi e madhe evropiane, përdoret si referencë një mbret i gjinisë mashkullore.

Lëvizja feministë në Britani gjatë viteve 1911-1914 pas një shpjegimi shumë të shkurtër shoqërohet me fjalitë: “Shoqëria britanike përjetoj një rënie të besimit tek ligji, arsyeja dhe kompromisi, të cilët kishin qenë zemra e filozofisë liberale. Politikani i madh britanik Uinston Çerçill do të shprehej: “Sistemet civile dhe parlamentare nën të cilat qytetari

anglez ishte mësuar prej kohës, kanë pësuar një sfidë të ashpër force dhe po bëhen pre e kërcënimeve dhe vrazhdësisë”. (fq. 117) Ky shpjegim ja zbeh rëndësinë kësaj lëvizje të rëndësishme feministe.

2. Edhe në rastet kur trajtohet arsimit, kultura, arti apo letërsia, të gjitha shpjegimet u referohen djemve dhe burrave dhe në asnjë moment vajzave dhe grave, qoftë edhe për të treguar që mungonte apo u është mohuar kjo e drejtë.

Për shembull:

Edukimi spartan (fq.13) ku shpjegohet me detaje si kryhej edukimi dhe stërvitja e djemve dhe nuk përmendet në asnjë moment çfarë ndodhte me vajzat.

Kultura, arsimit, arti dhe letërsia arabe (fq. 38) ku shpjegohet me detaje përparësia që i dha Muhamedi arsimin dhe edukimit, por në çdo moment i referohet burrave, poetëve, filozofëve, shkencëtarëve, mjekëve, arkitektëve, etj., por në asnjë moment nuk përmenden gratë, arritjet apo mungesa e edukimit për to.

Letërsia: Klasa e 11-të; **Autorët/et:** Ymer Çiraku, Adriatike Lami, Irena Ndoci, Elsa Skënderi;
Shtëpia Botuese: PEGI

Që në hyrje, në ndryshim nga shumë tekste të tjera të së njëjtës shtëpie botuese, ky tekst i referohet vetëm gjinisë mashkullore “nxënësve”, “autorit”, etj.

Në këtë tekst të gjitha veprat që trajtohen gjerësisht janë vetëm ato të autorëve të gjinisë mashkullore (9 vepra), për të cilët jepen detaje si për veprën, ashtu edhe për jetën e tyre.

Në pjesën i dedikohet studimit të tekstit, shpesh herë nxënësi/nxënësja nxitet që të reflektojë dhe të vlerësojë pamjen e jashtme të personazheve kryesorë sidomos të grave dhe vajzave. Konkretisht në një rast nxënësi/nxënëses i kërkohet të diskutojnë rreth “Magjepsjes që ngjall Esmeralda” (fq. 75).

Në tabelën që përshkruan karakteristikat e heroit dhe heroinës bajroniane vihet re që heroit ka tiparet: i virtytshëm, trim, melankolik, fytyrëzbehtë, miku më i mirë i tij është qeni dhe magjepsset lehtë nga bukuria e një gruaje. Në anën tjetër heroina ka vetëm tipare: e ndjeshme, e përkushtuar, e dashur dhe besnike deri në vdekje. (fq. 88) Në fakt heroinat në veprat bajroniane, kanë gjithashtu edhe disa tipare që në këtë skemë i janë atashuar vetëm heronjve: ato janë të virtytshme dhe trime.

Gjatë shpjegimit të letrës formale drejtuar Akademisë Mbretërore të Shkencave të Suedisë, përkatësisht Komitetit të Nobelit, autori i letrës i drejtohet këtij institucioni me shprehjen “Të nderuar zotërinj!”, duke lënë nxënësin/nxënësen të kuptojë që në këtë institucion ka vetëm akademikë të gjinisë mashkullore, në fakt, nga një kërkim i thjeshtë në internet mund të shohim se në fakt ky komitet ka në përbërjen e tij 6 anëtarë gra nga 18 anëtarë në total.

Historia: Klasa e 11-të; **Autorët/et:** Prof. Dr. Petrika Thëngjilli, Prof. Dr. Lorenc Bejko, Prof. Dr. Fatmira Rama, Prof. Dr. Ajet Shahu, Msc. Anila Beshaj. **Shtëpia Botuese:** PEGI

Ka elementë të pranishëm së grave në momente të ndryshme të historisë, si p.sh., në Rilindjen Shqiptare, apo në vitet 20-30. Këto pjesë do të mund të zhvilloheshin pak më gjatë. Mund të kishte dhe një pjesë në lidhje me pjesëmarrjen e grave në rezistencën antifashiste.

Në faqen 181 jepet një foto e Sabiha Kasimatit dhe Musine Kokalarit. Do të ishte më mirë sikur të sqarohesh pak më shumë rasti i tyre, të shpjegohej dhe rëndësia që kanë pasur këto dy gra intelektuale me veprën e tyre.

Letërsia: Klasa e 12-të **Autorët/et:** Prof. Dr. Ymer Ciraku, Prof. Dr. Irena Ndoci, Prof. Asoc. Dr. Anila Mullahi, Dr. Kastriot Gjika, Msc. Albana Haxhiu; **Shtëpia Botuese:** PEGI

Teksti flet vetëm për autorë burra. Që në hyrje të tekstit, tek tabela e përmbajtjes, të gjithë shkrimtarët e paraqitur janë burra. Sigurisht, që për shumë arsye, ka më shumë shkrimtarë të njohur burra sesa gra. Por, ekzistojnë dhe disa gra të cilat do të ishte mirë për t'u përfshirë, jo thjesht sepse janë gra, por sepse është e rëndësishme që vepra letrare, koncepti i shoqërisë përmes letërsisë të jepet dhe nëpërmjet qasjes së një shkrimtareje grua. Kjo vihet re si tek letërsia botërore ashtu dhe ajo shqiptare, ku në të gjithë librin nuk ka as edhe një shkrimtare grua, madje as fitueset e çmimit Nobel për letërsinë nuk përfshihen në asnjë nga rrymat/periudhat e përfshira.

Letërsia: Klasa e 12-të **Autorët/et:** Prof. Dr. Irena Lama, Dr. Drita Isufaj, Prof. Asoc. Dr. Anila Mullahi, Msc. Rezarta Alla; **Shtëpia Botuese:** PEGI

Ninullat: faqe 32, shpjegohet që ka një ndarje gjinore që në ninulla, por kjo nuk shoqërohet me një analizë në lidhje me këtë ndarje gjinore. Çfarë pasojash mund të ketë në shoqëri nëse ninullat janë të ndara për vajzat (bukuria) dhe për djemtë (trimëria).

Këngët e dasmës: faqe 35, do të ishte mirë të kishte një analizë më të detajuar të teksteve në lidhje me rolet gjinore; për shembull çfarë do të thotë në faqen 37 fjalia “vargjet pasqyrojnë çaste të lumtura të jetës vajzërore që mbeten pas?; pse ka një konotacion të dhimbshëm të martesës në lidhje me vajzën?; a pasqyrojnë këto pozitën e pabarabartë të gruas, etj.?”

Autorët e analizuar janë vetëm burra: De Rada, Gavril Dara, Naim Frashëri, Çajupi, Lasgush Poradeci, Dritëro Agolli. Ndoshta është më lehtë për t'u referuar veprave të autorëve burra sepse veprat e tyre janë më të njohura dhe të dukshme se sa ato të autoreve gra, por do të ishte shumë mirë, nëse do të bëhej përpjekja për të përfshirë edhe autore gra, edhe nëse janë më pak.

Fjalët e urta: faqe 113. Është shumë e nevojshme analiza sociologjike e fjalëve të urta, që edhe pse shpesh mund të përmbajnë “urtësinë” popullore, shpesh përforcojnë dhe përsërisin paragjykime dhe stereotipe ndaj grupeve të ndryshme shoqërore.

Faqe 114: Fjalët e urta në lidhje me “ndjenjat estetike”, një ndër shembujt e marrë është “E bukur si peri, mendtë firifiu”, një proverb që përforcon stereotipin se vajzat/gratë janë vetëm të bukura dhe të paditura.

Faqe 115 “Pse rron burri? Për një namuz”/ “Nga je, nga fshati i gruas”.

Faqe 116: Tek vlerësimi i fjalëve të urta, flitet vetëm me konotacion pozitiv, me një mungesë të theksuar vështrimi kritik ndaj fjalëve të urta. Vërtet, fjalët e urta kanë vlerë të rëndësishme, por është e nevojshme një qasje kritike ndaj tyre, që si përfaqësuese të fjalorit popullor mund të përmbajnë edhe forma paragjykimi dhe diskriminimi. Janë shumë të vlefshme për të analizuar pikërisht stereotipet, normat mbizotëruese në shoqëri, dhe analiza e tyre duhet të jetë kritike.

Faqja 133 - Legjenda e Rozafës - analiza nën këndvështrimin gjinor është shumë e mangët, nuk shpjegohet se pse përzgjidhet gruaja, duke e lidhur me faktin se gruaja është konsideruar si ajo që duhet të durojë sakrificat dhe duhet të sakrifkohet. Po në të njëjtën faqe thuhet se gruaja sakrifkohet si personifikim i forcës së jetës dhe pjellorisë, duke e reduktuar gruan vetëm me rolin e saj si nënë. Do të ishte mirë që ky shpjegim, që mund

të ketë qenë i vërtetë për kohën, të jepet i analizuar sipas njohurive dhe zhvillimeve të sotme, dhe duke mos ripërsëritur e përforcuar koncepte e tradita që e konsiderojnë gruan vetëm si një makinë fëmijësh.

As legjenda e Rozafës as ajo e Doruntinës nuk ofrojnë një shpjegim të sjelljeve shoqërore dhe të aspekteve patriarkale të shoqërisë. Do të ishte shumë e rëndësishme për ti përdorur këto legjenda për të analizuar trajtimin e gruas dhe pozitën e saj të dominuar, që nuk e zgjedh dot vetë bashkëshortin, apo që duhet të sakrifikohet, apo që duhet të ruajë nderin e familjes.

Analiza e eposit të kreshnikëve: Në faqen 175 figura femërore dhe funksioni i tyre, si dhe rrëmbimi i çikave. Në këtë analizë flitet vetëm me nota heroike në lidhje me gratë, por nuk jepet dhe këndvështrimi që në fakt, ky përshkrim i grave thjesht si shërbyese, si ruajtëse nderi, apo thjesht si plaçkë për tu rrëmbyer e ndarë, tregon për pozitën inferiore të grave. Nga njëra anë kemi lartësimin e burrërisë vetëm nëpërmjet dyluftimeve dhe vrasjeve, dhe nga ana tjetër kemi rolin e grave ose duke u sakrifikuar për burrat apo vëllezërit, ose duke u rrëmbyer sa nga njëra palë apo tjetra.

Do të ishte një tekst shumë i mirë për të analizuar dimensionin patriarkal të shoqërisë, mungesën e roleve femërore të rëndësishme, si luftëtare, dhe jo vetëm trajtimin e tyre si nëna, apo si gra të përvuajtura.

Gjuha Shqipe: Klasa e 12-të: **Autorët/et:** Prof. Dr. Mimoza Gjokutaj, Prof. As. Dr. Kledi Shegani, Prof. As. Dr. Flora Koleci, Dr. Elsa Skënderi, Msc. Rezarta Alla: **Shtëpia Botuese:** PEGI

Në faqen 35 të këtij tekstin të gjithë personazhet janë burra, Gigi Buffon, Ludëig Van Bethoven, Goethe, Trump, Stephan Haëking, por në përgjithësi, është një tekst i ekuilibruar.

BIBLIOGRAFIA

Akte normative ndërkombëtare

- Deklarata e Pekinit dhe Platforma për Veprim (1955) - <https://www.un.org/womenwatch/daw/beijing/pdf/BDPfA%20E.pdf>
- Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (1948) - <https://kmd.al/wp-content/uploads/2018/05/1524735491-DEKLARATA-UNIVERSALE-E-TE-DREJTAVE-TE-NJERIUT.pdf>
- <https://rm.coe.int/16803034e5>
- Karta për edukimin për qytetari demokratike dhe për të drejtat e njeriut (2010)
- Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut (1950) - https://www.echr.coe.int/documents/d/echr/convention_ENG
- Konventa kundër Diskriminimit në Arsim (1960) - <https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000188526>
- Konventa mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (1981) – <https://www.ohchr.org/sites/default/files/Documents/ProfessionalInterest/cedaw.pdf>
- Konventa për të Drejtat e Fëmijës (1989) - <https://www.ohchr.org/en/instruments-mechanisms/instruments/convention-rights-child>
- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (1966) - <https://www.ohchr.org/en/instruments-mechanisms/instruments/international-covenant-economic-social-and-cultural-rights>

Akte nromative kombëtare

- Ligji nr. 9970, datë 24.07.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”
- Ligji nr. 221, datë 4.2.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”
- Ligji nr. 15, datë 16.2.2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”
- Ligji nr. 23, datë 10.5.2018 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 247, datë 4.3.2010 “Për Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve”
- Ligji nr. 15, datë 13.3.2019 “Për nxitjen e punësimit”

Strategji dhe Marrëveshje

- Marrëvesha e Stabilizim-Asociimit. (n.d.) - <https://eur-lex.europa.eu/EN/legal-content/summary/stabilisation-and-association-agreement-with-albania.html>
- Strategjia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive 2023-2030. (n.d.-b) - <https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/561>
- Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi (SKPA, 2014-2020). (n.d.-b) - https://akpa.gov.al/wp-content/uploads/2020/07/Strategjia_per_Punesim_dhe_Aftesim_2014-2020.pdf
- Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2019 – 2022 . (n.d.-b) - https://financa.gov.al/wp-content/uploads/2020/10/Publikim_AL_Strategjia-Komb%C3%ABtare-p%C3%ABr-Pun%C3%ABsim-dhe-Aft%C3%ABsi-2019-2022.pdf